



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 25
Prishtinë, 16 dhjetor 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Flora Brovina, Qamile Morina, Nurishahe Hulaj, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Bujar Bukoshi dhe Teuta Hadri.

Munguan: Rita Hajzeraj, Sllobodan Petroviq dhe Gjylnaze Sylja.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Rishqyrtimi i Ligjit për ndërprerjen e shtatzënesisë Nr. 02/L-73;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen lidhur me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Rishqyrtimi i Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë Nr. 02/L-73

Sadik Idriz – I njoftoi anëtarët e Komisionit se kryetari i Republikës së Kosovës e ka kthyer për rishqyrtim Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë Nr. 02/L-73. Kryesia e Kuvendit, me vendim e ka ngarkuar Komisionin për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale për ta rishqyrtuar këtë ligj. Propozoi të formohet një grup i punës që të takohet me zyrtarët e Zyrës së Presidentit në mënyrë që të marrë informata më të hollësishme rreth vërejtjeve që i ka bërë Zyra e Presidentit për këtë ligj. Propozoi që kryesuese e këtij grupi të jetë deputetja Teuta Hadri, ndërsa anëtarë të jenë Armend Zemaj dhe Flora Brovina. Në mbledhjen e radhës ky grup pune duhet të dalë me propozime konkrete rreth këtyre vërejtjeve. E hapi diskutimin.

Teuta Hadri – Tha se Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë është shumë i mirë. Dy mandate është punuar në këtë ligj. Janë konsultuar profesionistë dhe janë organizuar dëgjime publike. Numri më i madh i neneve të këtij ligji janë bërë nga ekspertët gjinekologjike. Mendoj se Zyra e Presidentit nuk e ka analizuar mjaftueshëm Ligjin, sepse nuk ka e bërë ndarjen e planifikimit familjar nga veprimet krimnologjike. Fjala konsensus, domethënë pajtueshmëri. Neni 16 “marrëdhënie dhe shtatzëni jokonsensuale” është propozuar nga ekspertët, sepse problemi kryesor është me kategorinë e vajzave që bien pre e mashtrimeve për një lidhje dhe mbeten shtatzëna. Si të veprohet me këtë kategori të vajzave? Për gjinekologët ky është rast krimnologjik. Sipas vërejtjeve të kryetarit, neni 16 i këtij ligji është në kundërshtim me Ligjin për shëndetësi. Kjo nuk qëndron, sepse Ligji për shëndetësi e lejon ndërprerjen e shtatzënisë për rastet e dhunimit deri në javën e 22-të.

Pajtohem që grupi i punës të takohet me zyrtarët nga Zyra e Presidentit në mënyrë që të marrë informata të hollësishme lidhur me vërejtjet.

Flora Brovina – Tha se marrëdhënia seksuale jokonsensuale nuk nënkupton vetëm mungesën e martesës, por kjo ndodh edhe në martesë. Jam e mendimit që ky nen duhet të mbetet. Para disa ditësh e kemi publikuar një fletushkë në të cilën flitet për dhunën, duke përfshirë këtu edhe dhunën seksuale. Ka nevojë të kemi konsultime me Zyrën e Presidentit. Ndoshta edhe këshilltarët e tij kanë pasur nevojë të konsultohen me anëtarët e këtij komisioni.

Armend Zemaj – Ligji për shëndetësi, neni 110, e ndalon ndërprerjen e shtatzënisë pas javës së dhjetë, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni. Domethënë Ligji për shëndetësi nuk e parashih si rast inkriminues marrëdhënien seksuale dhe shtatzëninë jokonsensuale. Me këtë nen bie ndesh pika 2 e nenit 1 të Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë. Propozoj që të amendamentohet ky nen, si vijon: “*Marrëdhënia seksuale dhe shtatzënia jokonsensuale duhet të përcaktohen nga ekipi treanëtarësh i Komisionit*”.

Mimoza Ahmetaj – Tha se grupi i punës duhet të diskutojë edhe për vërejtjen që është bërë për rastet aksidentale. Në Ligj përmenden institucionet kompetente. Propozoj të përmenden se cilat janë ato institucione kompetente, duke e ditur se mjekësia ligjore është ajo që e bën vlerësimin e rasteve krimnologjike.

Nurisha Hula – Tha se thelbësore për të ndryshuar nenin 16 pika 1.2 “*marrëdhënie seksuale jokonsensuale*” është që kjo pikë të hiqet nga ky nen. Propozoj që rastet e ndërprerjes së shtatzënisë deri në javën e 22-të të kategorizohen në tri grupe: aspekti krimnologjik, vlerësimin e të cilit e bën komisioni profesional, aspekti socio-ekonomik, vlerësimin e të cilit e bën komisioni profesional, si dhe grupi i tretë - ndikimi i abortit në shëndetin e gruas që po ashtu e bën komisioni

profesional. Ndërprerje elektive të mbetet deri në javën e dhjetë, ndërsa rastet përjashtimore të vlerësohen nga komisionet profesionale.

Po ashtu propozoj që ndërprerja e shtatzënësisë që është si pasoj e marrëdhënies jokonsensuale të kufizohet në 12 ose 13 javë.

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Grupi i punës të takohet me zyrtarët e Zyrës së Presidentit. Ky grup pune përbëhet nga: Teuta Hadri – kryesuese e grupit, Flora Brovina – anëtare dhe Armend Zemaj – anëtar.

4. Të ndryshme

Qamile Morina – I njoftoi anëtarët e Komisionit për drafraportin me rekomandime lidhur me monitorimin e Ligjit për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi. Propozoj të organizohet një dëgjim publik dhe atë edhe për një arsye shtesë - ka kaluar një kohë e gjatë nga fillimi i monitorimit të këtij ligji dhe situata në terren ka ndryshuar dukshëm, prandaj të pranishmit në dëgjim publik do të ofronin të dhëna të mjaftueshme rreth zbatimit të këtij ligji.

Sadik Idriz – Tha se anëtarët e Komisionit do ta shqyrtojnë raportin preliminar për monitorimin e këtij ligji dhe do të deklarohen në mbledhjen e radhës rreth këtij raporti. Po ashtu Komisioni do të vendosë lidhur me propozimin për organizimin e dëgjimit publik.

Mbledhja përfundoi në orën 11:44.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz